



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 70/23 Prot.

Tiranë më, 26/08/2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLËRËSIMIT Z. PETRIT VEIZI

Nr. 36, datë 19.07.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Klevis Dhigoi
Erjana Pjetri
Ersa Karaj

Kryesues
Relatore
Anëtare

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, znj. Lediana Azemaj, më datë 19.07.2024, ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLËRËSIMIT: **Petrit Veizi**, me funksion Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Fier – Berat.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

Rregullore Nr. 197, datë 28.02.2023, “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes znj. Erjana Pjetri, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit Petrit Veizi, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Petrit Mustafa Veizi, është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit (04.07.2023), si Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Durrës - Kavajë.
 - 2.1 Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Nr. **, datë 25.01.2024, gjatë fazës së hetimit administrativ, z. Petrit Veizi, është transferuar dhe emëruar me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Fier - Berat, funksion organik i parashikuar në nenin 6, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
3. Subjekti i vlerësimit, z. Petrit Veizi, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar më datë 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 07, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit”, për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin Nr. 01, datë 25.07.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: z. Klevis Dhigoi (Kryesues), znj. Erjana Pjetri (Relatore) dhe znj. Ersa Karaj (Anëtare).

5. Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin Nr. 1, datë 24.07.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Petrit Veizi.
6. Relatorja e çështjes, znj. Erjana Pjetri, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 25.07.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore më datë 25.07.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
8. Relatorja e çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit për subjektin e vlerësimit z. Petrit Veizi, mbështetur në nenin 33/1, nenin 42 dhe nenin 46, të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, relatorja e çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse, si më poshtë vijon:
 - Formularin e deklaramit të pasurisë dhe dokumentacioni shoqërues, me shkresë përcjellëse Nr. *** Prot., datë 25.07.2023, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI);
 - Formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale me shkresë përcjellëse Nr. *** Prot., datë 25.07.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
 - Formularin e Kontrollit të Figurës, me shkresë përcjellëse Nr. *** Prot., datë 25.07.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve, bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:
 - Vlerësimin e pasurisë;
 - Kontrollin e figurës;
 - Vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e Vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar;

- b. Ligjin nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
- c. Ligjin nr. 40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;
- d. Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
- e. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 07, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”;
- f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe ILDKPKI-së Nr.15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklaratimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik, si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar”;
- g. Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”.

13. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet e rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- ❖ *Deklaratën e Pasurisë;*
- ❖ *Deklaratën për Kontrollin e Figurës;*
- ❖ *Formularin e Vlerësimit Profesional;*
- ❖ *Dokumentacionin bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet;*
- ❖ *Aktin e përfundimit të vlerësimit të pasurisë, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;*
- ❖ *Raportin mbi vlerësimin e aftësive profesionale, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore;*
- ❖ *Raportin mbi Kontrollin e Figurës, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore;*
- ❖ *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar;*
- ❖ *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;*
- ❖ *Bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*

14. Trupa e Vlerësimit, më datë 14.02.2024, pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Petrit Veizi, me Vendimin Nr. 3, datë 11.06.2024, vendosi:

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Petrit Veizi;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët; vlerësimin pasuror, kontrollin e figurës dhe atë profesional.*
- c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, nenet 35-40 dhe

45-47, të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

15. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pikat 12 dhe 14, të Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, si dhe nenit 3, pika 11 dhe nenit 5, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Petrit Veizi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative, në datë 12.07.2024 në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, Tiranë.
17. Në këtë seancë subjekti i vlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer duke kërkuar konfirmimin në detyrë.
18. Trupa e Vlerësimit zhvilloi seancën e dhënies së vendimit më datë 19.07.2024.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

19. Subjekti i vlerësimi z. Petrit Veizi, ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
20. Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë fazës së hetimit administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtuara nga relatorja, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues shtesë, me qëllim vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, sipas rastit dhe rrethanave të tjera të çështjes për sqarim, i kërkuar nga ana e relatores.

IV. PROCESI I VLERËSIMIT NGA TRUPA E VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, e veçanërisht në nenin 31 të këtij Ligji, ka për objekt deklarinin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
22. Në zbatim të nenit 32, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të

Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit z. Petrit Veizi ka dorëzuar deklaratën e pasurisë më datë 09.03.2023. Formulari i Pasurisë ka Nr. Indeksi **, datë 09.03.2023.

23. Procedurat e deklaramit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
24. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërisë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
25. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKIsë, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
26. Gjithashtu, ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, shlyerjen e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

27. Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur.
- Deklaratat e interesave private për të gjithë periudhën që ka qenë subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së.
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
- Shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare.
- Dokumentacionin e paraqitur në deklaramet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

28. Hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit konsistoi në:

- Verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit.
- Verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme.
- Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim.
- Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

29. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI:

29.1 Z. Petrit Veizi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003 dhe ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, si më poshtë:

- Para fillimit të detyrës në vitin 2003 dhe pas largimit të detyrës në vitin 2004, me nr. indeksi ****.

29.2 ILDKPKI, në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, Ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative; ka dërguar raport të hollësishëm nr. *** prot., datë 31.01.2024, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Petrit Veizi, ku është konstatuar se:

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- d) nuk është kryer deklarim i rremë;
- e) subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

PROCEDURA E VLERËSIMIT/HETIMIT E KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT

30. Bazuar në nenin 34 të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e vlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, (b) raportin/vlerësimin e kryer nga ILDKPKI; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private sipas nentit 34 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar; (ç) deklaratimet e subjektit të vlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.

31. Trupa Vlerësuese hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo ndonjë konflikti të interesit.

Trupa e Vlerësimit për vërtetimin e faktit administroi;

- a) Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur;

- b) Aktin përfundimtar të kontrollit të pasurisë nga ILDKPKI;
- c) Dokumentacionin e administruar nga ILDKPKI, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore si dhe nga instiucionet private dhe publike;
- d) Dokumentacionin e administruar nga deklaratimet e subjektit dhënë Trupës së Vlerësimit dhe ILDKPKI-së, si dhe përgjigje të pyetjeve të dërguara në rrugë zyrtare.

32. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kërkuar të dhëna nga institucione publike dhe private të cilat në bazë të ligjit janë të detyruara të japin të dhëna. ILDKPKI dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, u është drejtuar institucioneve të mëposhtme:

- Bankës së Shqipërisë;
- Bankave të niveleve të dyta;
- Institucione financiare jo bankare;
- Agjensia Shtetërore e Kadastrës;
- Drejtoritë Vendore në rreth dhe Zyrat Vendore të ASHK;
- ISSH;
- FSHU;
- 15 Shoqëri Rajonale Ujësjellës – Kanalizime;
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- QKB;
- One Albania sh. a;
- Vodafone Albania sh. a;
- Albania Satellite Communications shpk;
- ABISSNET sh. a;
- DIGICOM shpk;
- Regjistri Noterial Shqiptar.

DEKLARIMI I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT, PETRIT VEIZI.

Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

Pasuria Nr. 1

33. Apartament banimi me sip. 114.28 m², Rruga e Barrikadave, Pallati nr. **, H. *, Ap. **, Tiranë, blerë me 31.05.2005. Kontrate Shitje me nr. ***** rep., dhe nr. *** kol., datë 31.05.2005. **Burimi i krijimit:** Kredi “Dega e Bankes se Kursimeve Tirana-l”. Shuma: 5.000.000 lekë, nr. llogarie bankare debie *****. Vlera 44.570 usd. Zotëron 100%.

➤ ***Bashkëlidhur deklaratës:***

- Kontratë shitje (Pasuri e Paluajtshme) me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 24.05.2005, për apartament banimi me sip. 114.28 m², ne zonën kadastrale ***, nr. pasurie ****+*, apartament nr. *, kati i *, i përbërë 3+1, në objektin “Banesë 4, 8, 10 dhe 12 kate dhe 1 kat parking në tokë” në Krugën e Barrikadave, nr. ***, regjistruar ne Z.R.P.P Tirana 1, në regjistrin hipotekor me nr. **, datë 31.05.2004, me palë shitëse: Shoqëria “Delta Konstruksion” Sh.p.k., dhe palë blerëse shtetasin: Petrit Veizi, në vlerën 44.570 usd, vlerë e likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale.
- Vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 31.05.2004, nga Z.R.P.P Tirana 1, që konfirmon se në regjistrin hipotekor nr. 73, datë 31.05.2004, figuron e regjistruar ne pronësi te Shoqërisë “Delta Konstruksion” Sh.p.k.
- Harta treguese e regjistrimit, për pasurinë në zonën kadastrale ***, nr. pasurie ****+*, vol. **, fq. ***, adresa: rr. e Barrikadave, pronar: Delta Konstruksion Sh.p.k.
- Vërtetim nga dokumenti hipotekor datë 31.05.2005, nga Z.R.P.P Tiranë, që konfirmon se në regjistrin hipotekor nr. **, zk. ****, datë 31.05.2005, figuron e regjistruar në pronësi të Petrit Mustafa Veizi.
- Harta treguese e regjistrimit.
- Aplikim datë 26.05.2005 nga Petrit Veizi, për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës së pronësisë.
- Kontratë kredie për blerje banese, me nr. *** rep., nr. ***kol., datë 18.04.2003, me huadhënës: Banka e Kursimeve Tirana - 1 dhe huamarrës: Petrit Mustafa Veizi, për kredinë në shumën 5.000.000 lekë, me interes bankar 3% dhe afat 25 vjet. Kjo kontratë huaje bazohet në V.K.M. nr. 102, datë 05.03.1999, “Për trajtimin me strehim të Funkionarëve Politike dhe Nëpunësve Civilë të Administratës së Lartë Shtetërore”, e cila përbën të drejtën e aplikuar.
- Kontratë - Hipotekimi me nr. ***rep., dhe nr. ** kol., datë 23.01.2008, me hipotekues Petrit Mustafa Veizi dhe Altina Bajram Veizi, si dhe përfitues: Raiffeisen Bank Sh.a, me objekt hipotekimin e pasurisë së paluajtshme në dobi të përfituesit, për efekt të sigurimit të huasë së lëvruar nga përfituesi me kontratën e huasë datë 18.04.2003, në shumën 5.000.000 lekë.

HETIMI ADMINISTRATIV

34. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, ILDKPKI dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, u kanë kërkuar informacion Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Regjistrin Noterial, FSHU, 14 Shoqërive Rajonale Ujësjiellës – Kanalizime, institucioneve bankare dhe jo-bankare, si dhe u është drejtuar vetë subjektit.

Nga përgjigjet e administruara dhe të analizuara, rezultoi se:

35. ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Jug, me shkresë nr. ***, datë 13.09.2023, konfirmon se në emër te Petrit Mustafa Veizi, rezulton e regjistruar pasuria: Apartament me sip. 114.28 m², zk. ***, vol. ***, fq. ***.

Bashkëlidhur:

- Kartelë e pasurisë së paluajtshme për apartment banimi me sip. 114.28 m², me nr. pasurie ***+*, zona kadastrale ***, me adresë ruga e Barrikadave, në pronësi të Petrit Mustafa Veizi, regjistruar: nr. *****, datë 25.07.2013;
- Kërkesë nr. **, datë 11.07.2007, e Petrit Veizi, drejtuar ZRPP Tiranë;
- Harta treguese e regjistrimit.
- Vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 31.05.2004, nga Z.R.P.P Tirana 1, që konfirmon se në regjistrin hipotekor nr. **, date 31.05.2004, figuron e regjistruar në pronësi të shoqërisë “Delta Konstruksion” Sh.p.k, pasuria nr. ****+1, në zk. ***, apartament me sip. 114.28 m², ap. *, i përbërë 3+1, në objektin 4, 8, 10 dhe 12 kate + 1 kat parking, rruga e Barrikadave;
- Planimetria e apartmentit nr. 1.
- Kontrate shitje (Pasuri e Paluajtshme) me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 24.05.2005, me palë shitëse: shoqëria “Delta Konstruksion” Sh.p.k., dhe palë blerëse shtetasin: Petrit Veizi, në vlerën 44.570 usd, vlerë e likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale.
- Mandat pagese datë 24.05.2005, nga Raiffeisen Bank që konfirmon së shoqëria “Delta Konstruksion”, ka derdhur për regjistrimin në hipoteke, taksën e shitjes së apartmentit 114.28 m², zk. ***, blerës Petrit Veizi, në shumën 114.280 lekë.
- Aplikim “Kërkesë për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës së pronësisë” datë 26.05.2005 nga z. Petrit Veizi, për regjistrimin dhe lëshimin e certifikatës së pronësisë.
- Vërtetim i njësisë së kopjes me origjinalin me nr. **** rep., datë 22.10.2007, nga Dhoma e Noterëve Tiranë, për Vërtetimin e Pronësisë me nr. **, datë 31.05.2005 të paraqitur nga shtetasi Petrit Veizi.

36. Në proces - verbalin e datës 22.12.2023, subjekti sqaroi se: vlera e blerjes së apartmentit është 44.570 usd dhe është likuiduar në cash me këste, para lidhjes së kontratës së shitblerjes datë 24.05.2005, me burim kredi të butë nga shteti në Bankën e Kursimeve Tiranë, në vitin 2003. Pagesa e vlerës 44.570 usd është kryer cash nga shuma prej 5.000.000 lekë, e përfituar nga kredia shtetërore e marrë nga “Banka e Kursimeve” Tiranë, vlerë e cila, pas tërheqjes në bankë është konvertuar në usd, për arsye së kontrata me shoqërisë “Delta Konstruksion” Shpk., ishte që pagesa të kryhej në monedhën usd. Mandat pagesat nga shoqëria “Delta Konstruksion” Shpk, nuk i ka ruajtur për arsye të periudhës së gjatë kohore që ka kaluar nga blerja e apartmentit. Lidhur me pagesat ndaj shoqërisë “Delta Konstruksion” Shpk, disponon vetëm një mandat pagese. Për mobilimin e apartmentit ka shpenzuar një vlerë të përafërt rreth 150.000 lekë dhe është berë gradualisht ndër vite për zëvendësimin e orendive të amortizuara, pasi orenditë shtëpiake bazë, si pajisjet elektroshtëpiake i ka transferuar nga banesa e tjetër që ka shitur në qytetin e Peshkopisë. Nuk disponon mandat pagesash të blerjeve për mobilimin e apartmentit, për arsye të periudhës së gjatë kohore kur janë blerë, si dhe të tregut informal të kohës lidhur me blerjet.

37. Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

Apartamenti i banimit me sip. 114.28 m², në rrugën e “Barrikadave”, është përfituar me kontratë blerje në viti 2005, në vlerën 44.570 usd, me burim kredi shtetërore nga Banka e Kursimeve në vitin 2003, në vlerën 5.000.000 lekë. Ka deklaruar se orenditë shtëpiake bazë i ka transferuar nga banesa e tjetër që kishte në qytetin e Peshkopisë.

- **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Jug, me burim kredi shtetërore nga Banka e Kursimeve. Subjekti ka deklaruar shpenzime për arredimin e apartamentit me sip. 114.28 m², rreth 150.000 lekë.**
- **Nga verifikimi i të dhënave ka rezultuar se subjekti i vlerësimit ka pasur mundësi financiare për arredimin e apartamentit.**

Pasuria Nr. 2

38. Apartament banimi me sip. 48 m², lagjia “Nazmi Rushiti” - Peshkopi, **blerë:** dhënë nga shteti prindërve në vitin 1967, privatizuar në vitin 1994, regjistruar me nr. ****+*, zona kadastrale ****, në Z.R.P.P - Dibër. **Burimi i krijimit:** Trashëguar nga prindërit. **Shitur:** Kontratë shitje me nr. **** rep., dhe nr. *** kol., datë 10.04.2006, me vlerë 400.000 lekë. **Vlera** 0 lekë. **Zotëron** 100 %.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë shitblerje për pasuri të paluajtshme nr. **** rep., nr. *** kol., datë 10.04.2006, për apartament banimi me sip. 48 m², në zonën kadastrale ****, nr. pasurie ****+*, volumi **, faqe ***, me adresë: lagjia “Nazmi Rushiti” Dibër, me palë shitëse shtetasit: Petrit Veizi (përfaqësuar nga shtetasi A. H) dhe H. Veizi (Shehu) dhe palë blerëse shtetasin: B. B, në vlerën 400.000 lekë.
- Prokurë e Posaçme nr. **** rep., nr. *** kol., datë 22.12.2005, që konfirmon se i përfaqësuari Petrit Veizi emëron përfaqësues te posaçem, z. A. H, banues në Peshkopi.

HETIMI ADMINISTRATIV

39. ASHK, Drejtoria Vendore Dibër (Peshkopi), me shkresë nr. ***, datë 29.12.2023, konfirmon se në emër të subjektit Petrit Veizi dhe familjarëve të tij, nuk rezultojnë pasuri të regjistruara.

→ **Në proces - verbalin e datës 22.12.2023,** subjekti sqaroi se: nuk e disponon kontratën e shitblerjes me N.K Banesa Peshkopi për apartamentin 1+1, me sip. 48 m², në lagjen “Nazmi Rushiti” - Peshkopi, të privatizuar në vitin 1994, për arsye të kohës së gjatë që ka kaluar, si dhe për shkak se institucioni i N.K. Banesa Peshkopi nuk ekziston më, për të tërhequr kopje të kësaj kontrate.

Pjesa takuese e subjektit e përfituar nga të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti ishte e gjithë vlera 400.000 lekë, pasi familja e tij ka jetuar në këtë apartament edhe pas vdekjes së prindërve, ndërsa motra e tij H. Sh (Veizi) ishte e martuar dhe ka jetuar në apartamentin që ka me bashkëshortin e saj. Nga motra nuk i është kërkuar pjesë takuese nga të ardhurat nga shitja e apartamentit të sipërcituar. Likuiditetet e përfitura nga shitja e këtij apartamenti i ka përdorur për arredim të banesës së re të blerë në Tiranë dhe për nevoja familjare.

Paraqiti:

- Vendim Gjyqësor me nr. **, datë 24.02.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, me objekt: “Lëshimin e trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit Mustafa Veizi, duke përcaktuar si trashëgimtar ligjor të radhës së parë te tij: znj. H. Sh (Veizi) dhe z. Petrit Veizi, të cilët trashëgojnë në pjesë të barabarta, secili nga 1/2 pjesë të trashëgimisë”;
- Certifikatë e trungut familjar datë 11.12.2023, me vulë elektronike, që i referohet regjistrimit themeltar të vitit 1974, që konfirmon përbërjen familjare, si vijon: Mustafa Vathi Veizi, N. Veizi, H. Mustafa Veizi dhe Petrit Mustafa Veizi;

- Deklaratë e datës 10.12.2023, nga motra H. Sh, e cila deklaroi se: “nuk kam pasur asnjë pretendim financiar në lidhje me apartamentin. Theksoj se për shitjen e objektit në fjalë, nuk kam përfituar asnjë shumë monetare”.
- **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, lidhur me përfitimin dhe shitjen në vitin 2006 të apartamentit me sip. 48 m², në lagjen “Nazmi Rushiti”, Dibër.**

PASURI TË LUAJTSHME

40. Autoveturë tip Benz Mercedes (200D) me targa TR ****J, viti i prodhimit 1991. Blerë më 25.10.2003 (Kontratë: nr. *** rep., dhe nr. *** kol). **Vlera** 250.000 lekë. **Zotëron** 100%. **Burimi:** Kursime nga të ardhurat familjare. Shitur më 22.03.2004 (Kontratë: nr. **** rep., dhe nr. *** kol.), me vlerë 250.000 lekë.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Kontratë shitblerje automjeti me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 25.10.2003, për automjetin tip Mercedes Benz, me targa BA**** KB, me nr. shasië WDB*****, me palë shitese S. K dhe palë blerëse Petrit Veizi, në vlerën 250.000 leke.
- Kontrate shitblerje - automjeti me nr. **** rep., dhe nr. *** kol., datë 22.03.2004, me palë shitese Petrit Veizi dhe palë blerëse R.V, në vlerën 250.000 lekë.
- Dokument me nr. **** prot., 27.10.2003, nga Ministria e Rendit Publik, lënda: “Verifikim automjeti”, që konfirmon se mjete i markës Mercedes Benz, me nr. WDB*****, nuk rezultoi i vjedhur.
- Vërtetim zhdoganimi datë 23.10.2003, nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Dogana Tiranë, që konfirmon se shtetasi S. K ka kryer zhdoganimin automjetit tip Mercedes Benz, me nr. shasië WDB*****.
- Vërtetim Hyrje nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Dega e Doganës Durrës, datë 13.10.2003, që konfirmon hyrjen e automjetit të markës Mercedes Benz, me targa BA **** KB nga shtetasi S. K.
- Urdhër derdhje, date 23.10.2003, për pagesën e shumës 152.459 lekë në Bankën e Kursimeve Sha., nga shtetasi S. K për zhdoganimin e mjetit.
- Certifikatë pronësie datë 30.09.2003 (në gjuhën italiane) për automjetin tip Mercedes Benz, me targa BA****KB, me nr. shasië WDB*****, në pronësi të shtetasit S. K.
- Leje qarkullimi automjeti datë 23.10.2003 (e përkthyer), e shtetasit S. K për automjetin tip Mercedes Benz, me targa BA****KB, me nr. shasië WDB*****.

✚ **Hetimi administrativ**

41. DPSHTRR, me shkresë me nr. **** prot., datë 09.08.2023, konfirmon se Petrit Veizi dhe familjarët e tij, nuk kanë mjete të regjistruara në pronësi të tyre.

DPSHTRR, me postë elektronike, datë 24.11.2023, konfirmon se Petrit Veizi ka pasur të regjistruar automjetin tip Mercedes Benz me targa AA****AY (ish targa TR****J me nr.shasië WDB*****,

blerë me Kontratë Shitblerje Automjeti, me nr. **** rep., dhe nr. *** kol., datë 25.10.2003, në vlerën 250.000 lekë, të cilin e ka shitur me Kontratë Shitblerje - Automjeti, me nr. **** rep., dhe nr. *** kol., datë 22.03.2004, në vlerën 250.000 lekë. Mjeti tip Mercedes Benz, me targa AA***AY, me nr.shasie WDB*****, rezulton se është hequr nga qarkullimi me Vërtetimin nr. SHF*****, datë 21.11.2018.

- **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR, lidhur me mjetin tip Mercedes Benz.**

42. Kursime nga puna në ish - SH.Ç.B.A (A.M.P) në Ministrinë e Brendshme për periudhën 01.10.2015 deri 09.03.2023, sipas vërtetimit të Bankës Credins, datë 09.03.2023. **Vlera:** 2.196.934 lekë. **Zotëron 100 %.**

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

43. Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, datë 09.03.2023, që konfirmon se Petrit Veizi ka llogari page me gjendje në datë 09.03.2023, në shumën 2.196.934 lekë.

44. **Credins Bank**, me shkresë me nr. *** prot., datë 27.09.2023, konfirmon se Petrit Veizi ka llogari page me gjendje në datë 09.03.2023, në shumën 2.196.934 lekë.

45. **Në proces verbalin e datës 22.12.2023**, subjekti sqaroi se burimi i krijimit të gjendjes së llogarisë së pagës, në datë 31.12.2016, në Credins Bank, në shumën 490.868 lekë, e cila për vitin 2016 rezulton e shtuar në shumën rreth 477.000 lekë, janë të ardhurat nga pagat, shtesë e parapagesës së pagës mujore për muajin janar, dieta të prapambetura, të cilat janë berë si parapagesë në muajin dhjetor 2016 dhe shpërblimi për Vitin e Ri. Përveç të ardhurave nga pagat e subjektit, bashkëshortja e tij Altina Veizi ka punuar për periudhën korrik 2009 - dhjetor 2016, si llogaritare në biznese të ndryshme Bar - Kafe, me pagë mesatare mujore 30.000 lekë, pagesa të cilat i ka marrë cash, pasi nuk ka qenë e siguruar, sepse punëdhënësi nuk pranonte lidhjen e një kontrate zyrtare. Të ardhurat nga pagat e bashkëshortes (e pasiguruar), nuk kanë shërbyer për krijim asetesh, por vetëm për të mbuluar shpenzimet bazë jetike.

- **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank, me burim krijimi të ardhurat nga pagat.**

46. **Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, Sektori i Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale, pranë Ministrisë së Drejtësisë, bënë me dije se:**

Për subjektin e vlerësimit z. Petrit Veizi dhe personat e lidhur, nuk rezultojnë veprime/akte noteriale të kryera përveç atyre që ka deklaruar subjekti i vlerësimit.

- ✓ **Përputhen deklaratimet e subjektit me dokumentacionin e dorëzuar nga Regjistri Noterial.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga puna si Inspektor Zone, në Degën e Punëve të Brendshme Mirditë, për periudhën 01.08.1990 deri në 01.11.1991, sipas vërtetimit datë 24.04.2018, të Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë. (Nuk disponohet dokumentacion nga ngjarjet e vitit 1997). Shuma 13.950 lekë.
- Të ardhura nga puna si Inspektor Zone - Shef Sektori - Zv. Drejtor - Drejtor Drejtorie: Drejtoria e SHIK - Dibër, për periudhën 01.11.1991 deri në 16.11.2001, sipas vërtetimit nr. ****, datë 27.04.2018 të “Drejtoria e Administrimit e Sigurisë së Burimeve Njerëzore” - SHISH Tiranë. Shuma 1.836.463 lekë.
- Të ardhura nga puna si Drejtor i SH.K.B-së në Ministrinë e Brendshme, për periudhën 16.11.2001 deri në 10.02.2004, sipas Vërtetimit nr. ****, datë 24.04.2018 të Drejtorisë së Financës së Ministrisë së Brendshme. Shuma 2.118.831 lekë.
- Të ardhura nga puna si Specialist në Akademinë e Policisë dhe Reformë për periudhën 01.05.2004 deri në 30.06.2009, sipas Vërtetimit nr. **, datë 20.04.2018, të “Akademia e Sigurisë” Tiranë. Shuma 2.361.849 lekë.
- Të ardhurat nga puna si Manaxher-Furnitor, në aktivitet privat (lokal) për periudhën 01.07.2009 deri në 01.04.2014. Nuk disponoj kontratë pune, pasi nuk kam qenë i siguruar. Shuma 2.750.000 lekë.
- Të ardhurat nga shitja e apartamentit të banimit me sip. 48 m², Lagjia “Nazmi Rushiti”, Peshkopi, dhënë nga shteti prindërve në vitin 1967, privtuzuar në vitin 1994, regjistruar me nr. ****, zona kadastrale nr. **, në Z.R.P.P -Diber. Shitur: Kontratë shitje me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 10.4.2006. Shuma 400.000 lekë.
- Të ardhura nga shitja e autoveturës tip Benz Mercedes (200D) me targa TR ****J, vitit i prodhimit 1991. Shitur me 22.03.2004 (Kontratë: nr. **** rep., nr. *** kol. Shuma 250.000 lekë.
- Të ardhura nga puna në ish - SH.Ç.B.A (AMP), në Ministrinë e Brendshme për periudhën 01.10.2015 deri në 09.03.2023, sipas vërtetimit të Bankës Credins, datë 09.03.2023. Shuma 9.309.534.69 lekë.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare, datë 24.04.2018 nga ISSH, që konfirmon se Petrit Veizi, për periudhën gusht 1990 - korrik 1991, ka realizuar të ardhura me punëdhënësin Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, për të cilat nuk ka bordero.
- Vërtetim me nr. **** prot., datë 27.04.2018, nga SHISH, Departamenti Organizativ dhe i Bashkëpunimit, Drejtoria e Administrimit dhe Sigurisë së Burimeve Njerëzore, që vërteton se z. Petrit Veizi, ka qenë punonjës në Shërbimin Informativ Shtetëror, nga data 01.11.1991 deri në 16.11.2001. Gjatë kësaj periudhe ka realizuar të ardhura neto në shumën prej 1.836.463 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. **** prot., datë 24.04.2018, nga ISSH, që konfirmon se Petrit Veizi, për periudhën 16.11.2001 - 16.03.2004, ka realizuar të ardhura nga paga neto me punëdhënësin Ministria e Brendshme, në shumën 1.956.831 lekë.
- Vërtetim nr. ** prot., datë 20.04.2018, nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë që konfirmon se z. Petrit Veizi, ish-punonjës në Akademinë e Sigurisë, për periudhën 01.05.2004 - 30.06.2009, ka përfituar të ardhura neto nga paga në shumën rreth 2.361.849 lekë. Për periudhën 01.05.2004 - 31.12.2005 ka përfituar të ardhura neto nga paga në shumën rreth 1.228.036 lekë.
- Pasqyra përmbledhëse e pagës datë 20.04.2018, që konfirmon se Petrit Veizi për periudhën tetor 2015 - dhjetor 2017 ka përfituar të ardhura neto nga pagat, në shumën 2.210.105 lekë.

- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, datë 09.03.2023, që konfirmon se Petrit Veizi ka llogari page dhe për periudhën 10.11.2015 - 09.03.2023, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat, dietat, etj., nga SHKB, dhe AMP, në shumën rreth 9.285.557 lekë.
- Në datë 18.11.2020 i është kredituar në llogarinë e pagës nga Intersig Viena Insurance G, likuidim dëmi në shumën 23.475 lekë.

47. Raiffeisen Bank, me postë elektronike, datë 20.12.2023, konfirmon se Petrit Veizi ka pasur llogari page dhe për periudhën 01.01.2006 - 01.07.2009, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat dhe reforma, në shumën rreth 1.823.463 lekë.

48. Credins Bank, me shkresë me nr. **** prot., date 27.09.2023, konfirmon se Petrit Veizi ka llogari page dhe për periudhën 10.11.2015 - 09.03.2023 i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat, dietat, etj., nga SHKB, SHÇBA, AMP, në shumën rreth 9.285.557 lekë.

- Në datë 18.11.2020 i është kredituar në llogarinë e pagës nga Intersig Viena Insurance G, likuidim dëmi në shumën 23.475 lekë.

49. ISSH, me shkresë me nr. **** prot., datë 11.08.2023, konfirmon se Petrit Veizi, për periudhën tetor 2015 - mars 2023, ka përfituar të ardhura neto nga pagat nga Shërbimi per Çështjet e Brendëshme dhe Ankesat, si dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore.

50. ISSH, me shkresën nr. **** prot., datë 11.08.2023, konfirmon se i ka dërguar shkresë Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, për të konfirmuar të ardhurat e realizuara nga shtetasi Petrit Mustafa Veizi dhe familjarët e tij, për periudhën para vitit 2012.

ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën kthim pergjigje me nr. *** prot., datë 17.08.2023, nuk konfirmon të dhëna për periudhën 1994 - 2012, për shtetasin Petrit Mustafa Veizi dhe familjarët e tij.

51. Në proces verbalin e datës 22.12.2023, subjekti sqaroi se të ardhurat nga pagat si Specialist në Akademinë e Policisë dhe të ardhurat nga reforma për periudhën 01.05.2004 deri në 30.06.2009, janë përfituar si vijon: deri muajin prill 2005 të ardhurat janë paguar me bordero, ndërsa nga muaji maj 2005 pagat i kanë kaluar në sistemin bankar, në Raiffeisen Bank deri në muajin korrik 2009, duke përfshirë edhe pagesat për reformën.

- Sqaroi se, nga puna ne Policinë e Shtetit ka patur shkëputje, si vijon: për periudhën e viteve 2007 deri në 30.06.2009 ishte në reformë dhe është trajtuar me pagesë kalimtare, ndërsa për periudhën korrik 2009 - tetor 2015, nuk ka punuar në Policinë e Shtetit dhe nuk ka marrë pagë. Lidhur me këtë fakt i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar vërtetimin nr. 74 prot., datë 20.04.2018, nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë që konfirmon periudhën e pagesave deri në muajin qershor 2009. Ka rifilluar punë në Policinë e Shtetit në muajin tetor 2015, kur kanë filluar edhe marrëdhëniet financiare, sic konfirmohet edhe nga dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga Credins Bank, të cilën i'a ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar.
- Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga puna si Manaxher-Furnitor në aktivitet privat (lokal), për periudhën nga data 01.07.2009 deri në 01.04.2014, sqaroi se për këtë periudhë kohore, e përkon me periudhën kur nuk ka punuar në Policinë e Shtetit, ka punuar i pa siguruar, sepse punëdhënësi nuk pranonte lidhjen e një kontratë zyrtare punësimi. Për aktivitetin privat ku ka punuar si manaxher-furnitor, nuk mund te siguronte dokumenta justifikues, pasi këto aktivitete aktualisht janë të

mbyllura. Gjatë kësaj periudhe nuk ka krijuar asete dhe të ardhurat nga pagat i kanë shërbyer vetem për të mbuluar shpenzimet bazë jetike.

- Vlera e kredituar në shumën 23.475 lekë në llogari në Credins Bank, në datë 18.11.2020 nga Intersig Viena Insurance G, ishte për rregullimin e mjetit me targa AA *** VE, për shkak të një aksidenti rrugor që i ka ndodhur me mjetin. Ky mjet është në pronësi të institucionit AMP, kur subjekti punonte si Drejtor në AMP, Drejtoria Rajonale Kukës.

Paraqiti:

- Vërtetim për Bazën e Vlerësueshme dhe Pagën Neto Mesatare, nga Drejtoria Vendore Policisë Dibër, që konfirmon se për periudhën 01.08.1990 deri në 03.12.1992, ka përfituar të ardhura nga paga neto në shumën 41.050 lekë. Për periudhën 01.08.1990 - 1991 ka përfituar të ardhura në shumën 11.050 lekë.

52. Në datë 08.01.2024, subjekti dorëzoi:

- Autorizim me nr. **** prot., datë 16.11.2020 nga Qendra e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, Ministria e Brendshme, që autorizon z. Petrit Veizi, si drejtues i mjetit me targa AA***VE, të ndjekë të gjitha procedurat me kompaninë Intersing Sha, si dhe vlerën financiare në lidhje me mjetin në përdorim të SHÇBA-së, e aksidentuar më datë 23.10.2020. Mjeti është në dispozicion të Drejtorisë Rajonale të SHÇBA-së Kukës dhe në inventar të QSHAMT.
- Urdhër nr. ****, datë 02.03.2020 “Për caktimin në detyrë dhe transferimin e një punonjësi të SHÇBA-se”, nga Ministria e Brendshme, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, që konfirmon se Drejtues z. Petrit Veizi, me detyrë Specialist Hetimi, në Drejtorinë e Hetimit në Drejtorinë e Përgjithshme të SHÇBA-së Tiranë, transferohet dhe caktohet në detyrë Drejtues i Drejtorisë Rajonale Kukës-Dibër, në Drejtorinë e Përgjithshme të SHÇBA-së.
- Urdhër nr. ***, datë 31.01.2023 “Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësi të AMP-së”, që konfirmon se z. Petrit Veizi, me detyrë Drejtor në Drejtorinë Rajonale Kukës-Dibër, transferohet dhe emërohet në detyrën Drejtor në Drejtorinë Rajonale Durrës-Kavajë, në Drejtorinë e Përgjithshme të AMP-së.
- ❖ Të ardhurat neto të subjektit nga paga, shpërblimet, reforma etj, në SHISH dhe Policinë e Shtetit për periudhën gusht 1990 - qershor 2009 dhe nëntor 2015 - mars 2023, të dokumentuara, konfirmohen në vlerën totale rreth 16.141.000 lekë.
- ❖ Për periudhën korrik 2009 - prill 2014, subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën rreth 2.750.000 lekë, nga puna si Menaxher - Furnitor, në aktivitet privat (lokal) i pasiguruar, për të cilat nuk disponon dokumentacion justifikues. Këto të ardhurat nuk kanë shërbyer për krijim asetesh, por vetëm për të mbuluar shpenzimet bazë jetike.
- ❖ Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me arsyen e kreditimit të shumës 23.475 lekë, në llogarinë e tij në Credins Bank, në datë 18.11.2020, nga Intersig Viena Insurance Group.

DETYRIMET FINANCIARE

- 53.** Kredi “Dega e Bankës së Kursimeve Tirana-l”, për blerjen e apartamentit, disbursuar më 18.04.2003, në shumën 5.000.000 lekë, me afat 25 vjet (18.04.2028), me këst mujor 23.711 lekë,

me principal fillestar 11.211 lekë, me interes bankar 3 % në vit, me nr. 3032 rep., dhe nr. 833 kol. Transferuar kredia në Raiffeisen Bank sh.a, më 23.10.2004, për arsye të blerjes së aksioneve të Degës së Bankës së Kursimeve Tirana-I, nga kjo bankë. Nr. llogarie bankare debie *****. Shuma e detyrimit financiar 3.408.000 lekë.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës.**

- Shkresë me nr. *** prot., datë 09.04.2002, nga Ministra e Rendit Publik, Drejtorja e Burimeve Njerëzore që konfirmon se Petrit Veizi me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik është trajtuar me kredi për strehim, në bazë të V.K.M, nr. 102, datë 05.03.1999, “Për trajtimin me kredi për strehim”.
- Shkresë me nr. *** prot., datë 20.12.2002, nga Ministra e Rendit Publik, që konfirmon kërkesën për miratimin e një kredie për strehim për z. Petrit Veizi me detyrë Drejtor i Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik, në bazë të V.K.M, nr. 102, datë 05.03.1999 “Për trajtimin me strehim të funksionarëve Politikë dhe Nëpunësve Civilë të Administratës së Lartë Shtetërore”.
- Kontratë huaje për blerje banesë, me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 18.04.2003, me huadhënës Banka e Kursimeve Tirana-1 dhe huamarrës Petrit Mustafa Veizi, për kredinë në shumën 5.000.000 lekë, me interes bankar 3 % dhe afat 25 vjet. Bazohet në V.K.M., me nr. 102, datë 05.03.1999, “Për trajtimin me strehim të Funksionarëve Politikë dhe Nëpunësve Civilë të Administratës së Lartë Shtetërore”, e cila përbën të drejtën e aplikuar.
- Kontratë - Hipotekimi me nr. 376 rep., dhe nr. 40 kol., datë 23.01.2008, me hipotekues Petrit Mustafa Veizi, Altina Bajram Veizi dhe përfitues: Raiffeisen Bank Sh.a, me objekt hipotekimin e pasurisë së paluajtshme në dobi të përfituesit, për efekt të sigurimit të huasë së lëvruar nga përfituesi.
- Vërtetim hipotekor, datë 12.11.2007 dhe Harta treguese e regjistrimit datë 10.11.2007.
- Mandat pagesash nga Banka e Kursimeve Tirana-I, që konfirmon se Petrit Veizi, për periudhën prill 2003 — shtator 2004, ka kryer derdhjet e kësteve të kredisë në llogarinë me nr. *****.
- Rezultojnë 18 mandate me 24.000 lekë/muaj, me shumë totale rreth 432.000 lekë.
- Mandat pagesat nga Raiffeisen Bank, që konfirmojnë se Petrit Veizi, për periudhën tetor 2004 — 18.01.2010, ka kryer derdhjet e kësteve të kredisë në llogarinë me nr.*****.

Rezultojnë 40 mandate me 24.000 lekë/muaj dhe 100.000 lekë/muaj për 2 muaj, me shumën 1.160.000 lekë.

Kontratë për llogari të pafrytshme me nr. *****, datë 29.10.2015, lidhur midis Credins Bank Sha dhe Petrit Veizi për Karta Visa Electron.

54. Raiffeisen Bank. me shkresë me nr. **** prot., datë 07.08.2023, përcjell CD që konfirmon se Petrit Veizi ka llogari rrjedhëse në lekë dhe për periudhën 20.10.2004 - 18.1.2010, ka kredituar në llogari pagesat për shlyerje këste kredie, në shumën rreth 1.160.000 lekë. Rezulton se ka gjendje llogarie në shumën 0.04 lekë.

55. Raiffeisen Bank me postë elektronike datë 30.11.2023, konfirmon se klienti Petrit Mustafa Veizi, ka një kredi aktive në shumën 4.805.564 lekë, detyrimi aktual i kredisë është 6.740.627 lekë. Kjo

kredi është përfituar nga ish – Banka e Kursimeve. Sipas verifikimeve të aktivitetit të kredisë, gjendja e kredisë është deri në vitin 2010, pasi nuk janë kryer më pagesa pas datës 20.01.2010. Për këte arsye gjendja e principalit të kredisë vazhdon të jetë 4.191.702 lekë dhe çdo muaj është shtuar si rrjedhojë e penaliteteteve dhe interesave. **Bashkëlidhur:** Statementi bankar nga Raiffeisen Bank, që konfirmon gjendjen e kredisë.

Në proces verbalin e datës 22.12.2023, subjekti sqaroi, se për periudhën korrik 2009 tetor 2015, nuk ka punuar në Policinë e Shtetit dhe nuk ka përfituar paga. Në pamundësi të shlyerjeve të kësteve mujore të kredisë, për shkak të të ardhurave të pamjaftueshme, nga muaji shkurt 2010 nuk kanë kryer më pagesa për shlyerje të kësteve të kredisë. Këstet e kredisë kanë vazhduar të mos paguhen nga subjekti deri aktualisht. Lidhur me shlyerjet e kësteve të kredisë deri në muajin janar 2010, në Bankën e Kursimeve dhe Raiffeisen Bank, i ka bashkëlidhur deklaratës se vlerësimin kalimtar, mandatet e pagesave. Burimi i të ardhurave për shlyerjet e kësteve të kredisë, për periudhën prill 2003 —janar 2010, ishin të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të ardhurat e bashkëshortes nga asistenca e përfituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë. Që kur ka filluar punë në shtet, nga viti 1990 në SHIK (SHISH) dhe më pas në Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit, kanë kursyer nga ardhurat familjare sipas mundësive. Të ardhurat e kursyera i ka mbajtur në gjendje cash në shtëpi dhe për periudhën kur është marrë kredia në Bankën e Kursimeve në vitin 2003, i kanë përdorur me qëllim plotësimin e të ardhurave për mbulimin e shpenzimeve jetike, pasi një pjesë e pagës se tij ka shërbyer për shlyerje të kësteve të kredisë. Gjatë periudhës që ka shlyer këstet e kredisë ka limituar shpenzimet jetike, pasi jetonin vetëm me pagën e subjektit dhe asistencën e përfituar nga bashkëshortja nga Drejtoria Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë. Deklaroi se gjatë kësaj periudhe, për mbulimin e shpenzimeve jetike të familjes, janë ndihmuar edhe nga të afërmit e tyre.

Vlerën e gjendjes së detyrimit të kredisë e ka deklaruar me përafërsi, duke zbritur nga kredia e marrë në vlerën totale 5.000.000 lekë, vlerën e pagesave të kësteve të kredisë deri në muajin janar 2010, sipas mandat pagesave që ka dorëzuar. Nuk është njoftuar nga Raiffeisen Bank, për mospagesat e kësteve të kredisë dhe për interesat dhe penalitetet e shtuara ndër vite. Gjithashtu, nuk ka pasur informacion për gjendjen aktuale të kredisë. Është interesuar për të marrë një përfaqësues ligjor, për të sqaruar situatën e kredisë në Raiffeisen Bank dhe për të vijuar me shlyerjet e kësteve të kredisë.

56. Subjekti i vlerësimit në emailin e datës 03.06.2024, në lidhje me mos pagimin e kësteve të kredisë për blerjen e apartamentit të sipërcituar, deklaroi se:

- Për pagesat e detyrimit financiar prej 6.741.000 lekë për afatin vijues 4 vjeçar, kjo shumë do të shlyhet nga kursimet aktuale të mija personale që janë aktualisht në vlerën e 3.063.150 lekë të depozituara në nr. llogarie ***** në Credins Bank, ndërsa pjesa e mbetur e detyrimit do të shlyhet nga kursimet vijuese personale dhe të personave të lidhur (fëmijët) brenda afatit 4 vjeçar.

57. Gjithashtu, subjekti i vlerësimit u pyet dhe gjatë Seancës Dëgjimore të mbajtur më datë 12.07.2024, ku sqaroi përsëri se:

“Gjatë periudhës 2010 e aktualisht nuk kam paguar asnjë detyrim. Nga ana e bankës nuk kam pasur asnjë njoftim për mospagimin e kësteve të detyrimit për kredinë e marrë në vitin

2003. Aktualisht, jam në negociata me bankën për vijimësinë e pagimit të detyrimit. Duke qenë se afati i fundit i shlyerjes së kredisë është në vitin 2028, mendoj që do të shlyhet nga të ardhurat dhe kursimet e mija dhe të personave të lidhur. Nëse nuk plotësohet kjo vlerë për shlyerjen e kredisë do të shoh mundësinë e rivlerësimit të kredisë ose marrjen e një kredie tjetër për të mbyllur brenda afatit kredinë e marrë”.

❖ Konfirmohet kredia shtetërore marrë në vitin 2003, në Bankën e Kursimeve (më pas në Raiffeisen Bank), për blerje banese në shumën 5.000.000 lekë. Subjekti ka b/lidhur dokumentacion justifikues lidhur me shlyerjet e kësteve të kredisë, për periudhën prill 2003 - janar 2010, në shumën totale 1.592.000 lekë, me burim kursimet nga pagat. Nga muaji shkurt 2010 e në vijim, subjekti nuk ka shlyer këste kredie, konfirmuar edhe nga Raiffeisen Bank, sipas së cilës gjendja e principalit të kredisë është rreth 4.192.000 lekë, ndërsa detyrimi aktual i saj, në muajin mars 2023 është në vlerën rreth 6.741.000 lekë, përfshirë penalitetet dhe interesat bankare.

58. Huamarrje nuk disponoj.

59. Detyrime ndaj të tretëve nuk disponoj.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.**

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

60. Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur Periudha 01.01.2022 — 31.12.2022.

- Shpenzime për vitin e fundit, periudha: shkurt 2022 — shkurt 2023 për drita (unë, bashkëshortja dhe fëmijë). Sipas librezës të pagesës me nr. kontrate *****. Shuma 86.707 lekë.
- Shpenzime për vitin e fundit, periudha: shkurt 2022 shkurt 2023 për ujë (unë, bashkëshortja dhe fëmijë). Sipas librezës të pagesës me nr. kontrate *****. Shuma 38.905 lekë.
- Shpenzime për vitin e fundit, periudha: shkurt 2022 — shkurt 2023 për internet, kontrata e lidhur në emrin (Donald Veizi). Përafërsisht 18.000 lekë.
- Shpenzime për vitin e fundit, periudha: shkurt 2022 — shkurt 2023, për kontratat e numrave të telefonit pranë Vodafone për numrat: 0697*****, 069*****, 067*****, (bashkëshortja) , 069*****, (Armand Veizi), 069*****, (Donald Veizi). Përafërsisht 45.600 lekë.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Librezë nga OSHEE, në emrin e Petrit Veizaj, me nr. kontrate *****, që konfirmon se për vitin 2022 janë kryer pagesa për furnizimin me energji elektrike, në shumën totale rreth 89.797 lekë.
- Librezë nga UKT në emrin e Petrit Veizaj, qendra *****, që konfirmon se për vitin 2022 janë kryer pagesa për furnizimin me ujë në shumën totale rreth 40.171 lekë.

- Faturë pagese nga Digicom që konfirmon pagesat për shërbimin e internetit nga Donald Veizi për vitin 2022 në shumën 19.380 lekë.

61. **FSHU** me shkresën nr. ***** prot., datë 10.08.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Petrit Mustafa Veizi, për periudhën deri në datë 08.03.2023, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, nuk rezulton të ketë kontratë të furnizimit me energji elektrike.

Shtetasit: Altina Bajram Veizi, Armand Petrit Veizi, dhe Donald Petrit Veizi, referuar të dhënave të sistemit të faturimit, nuk rezultojnë të kenë lidhur kontrata të furnizimit me energji elektrike me FSHU.

62. **Shoqëria Rajonale Ujësjellës — Kanalizime Tiranë Sh.a.**, me shkresën nr. **** prot., datë 18.08.2023, konfirmon se në emer të z. Petrit Veizi rezulton kontrata me nr. *****, për objektin me adresë: rruga “Barigadave”, me status aktiv, në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrime të likuiduara deri në muajin mars 2023. Në emër të shtetasve: Altina Bajram Veizi, Armand Petrit Veizi dhe Donald Petrit Veizi, nuk rezulton asnjë kontratë për shërbimin e Ujësjellës Kanalizimet Tiranë sh.a, të regjistruara në sistem në emer të tyre.

63. **13 Shoqëri Rajonale të Ujësjellës — Kanalizime**, nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

64. **Vodafone Albania sh.a.**, me shkresën nr. 48/48, datë 03.11.2023, përcjell CD që, konfirmon se:

Petrit Veizi, ka të regjistruar 2 (dy) numra celulari: 069*****, me status: Aktiv, nga data 23.08.2018 dhe për vitin 2022 rezultojnë pagesa në shumën 16.952 lekë; 069***** me status: Aktiv, nga data 04.09.2014 dhe për vitin 2022 rezultojnë pagesa në shumën 0 lekë;

Altina Veizi, nuk i korrespondon asnjë numër celular i shoqërisë Vodafone Albania sha.

Armand Veizi, ka të regjistruar 4 (katër) numra celulari: 069***** me status: Aktiv, mbartur në datë 16.10.2020, në rrjetin e shoqërisë Vodafone Albania Sha dhe për vitin 2022 rezultojnë pagesa në shumën 13.200 lekë; 069***** me status: Aktiv nga data 07.08.2023; 069***** me status: Aktiv nga data 22.08.2023; 069***** me status: Inaktive nga data 24.07.2015 dhe në datë 06.04.2018 është larguar nga rrjeti i shoqërisë Vodafone Albania Sha.

Donald Veizi, nuk i korrespondon asnjë numër celular të shoqërisë Vodafone Albania Sha;

65. **Albania Satellite Communications shpk**, me shkresën nr. **** prot., datë 14.08.2023 nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti vlerësimit dhe personat e lidhur me të.

66. **Abissnet sh.a.**, me shkresën nr. **** prot., datë 14.08.2023 nuk konfirmon kontrata të lidhura nga subjekti vlerësimit dhe personat e lidhur me të.

67. **Digicom sh.a.**, me shkresën nr. **** prot., datë 09.08.2023, konfirmon se Donald Veizi ka marrë shërbimin internet nga shoqëria Digicom për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, me numër

kontrate ***** dhe është faturuar për periudhën janar – mars 2022 me vlerën 1.990 lekë/muaj dhe për periudhën prill — dhjetor 2022 me vlerën 1.490 lekë/muaj. Totali faturimit është 19.380 lekë.

Petrit Veizi dhe personat e tjerë të lidhur me të, nuk kanë marrë shërbim interneti nga shoqëria Digicom, për periudhën 01.01. 2022 — 31.12.2022.

- ✓ **Shpenzimet për ujë + drita + telefon + internet gjatë periudhës 01.01.2022 -31.12.2022 janë në shumën rreth 190.000 lekë.**

68. Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përbaluara - Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.

- Udhëtim Armand Veizi për arsye pune në shtetin Gjerman, ka kryer specializim (Hospitant në Klinikën e Neurologjisë Heinrich Braun Klinikum, Sachsen). Ka qëndruar nga data 28.02.2021 deri 18.04.2021, 50 ditë me shpenzimet nga Spitali. Shuma 0 lekë.
- Udhëtim ditor në Malin e Zi në datë 09.04.2022, Donald Veizi, me shpenzimet nga kompania ku është i punësuar “LUFTHANSA Frankfurt” dhe udhëtim nga data 27.06.2022 deri në 30.06.2022, me shpenzime nga kompania ku është i punësuar “LUFTHANSA Frankfurt”. Shuma 0 lekë.
- Udhëtim vajtje - ardhje nga Aeroporti i Rinasit për në Ankona, Itali, i Altina Veizi. Për periudhën 06.12.2021-06.12.2021, shpenzimet e udhëtimit të mbuluara nga motra. Shuma 0 lekë.

Djali Armand Veizi për periudhën 01.01.2020 — 31.12.2022 ka dalë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në datë 28.02.2021, nga Aeroporti i Rinasit për në Berlin, Gjermani dhe është kthyer në datë 18.04.2021 nga Pika Kufitare Murriqan. Vajtja e tij për në Gjermani, ishte pasi ishte pranuar si hospitant në Spitalin Heinrich-BraunKlinikum, Departamenti i Neurologjisë, për periudhën 01.03.2021 - 30.04.2021. Sqaroi se hospitimi ishte një hapësirë (praktikë) që i ofrohej një mjeku, për të cilin planifikohej edhe punësimi në të ardhmen nga ana e spitalit. Përmes kësaj praktike, mjeku njihet me stafin dhe praktikat e punës në spital, para se të punësohet definitivisht. Duke qenë se për qëndrimin si hospitant në Spitalin Heinrich-Braun-Klinikum në Gjermani, mjeku nuk paguhej, spitali i mundësonte akomodimin pranë territorit të tij, si edhe ushqimin pranë ambienteve të spitalit pa asnjë pagesë.

Djali Donald Veizi, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022 ka dalë 2(dy) herë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht në datë 09.04.2022 nga Pika Kufitare Murriqan me autobus për në Budva, Mal i Zi dhe është kthyer në datë 10.04.2022, si dhe në datë 27.06.2022, nga Aeroporti i Rinasit për në Frankfurt Gjermani, nëpërmjet Kompanisë Lufthansa dhe është kthyer në datë 30.06.2022. Sqaroi se udhëtimi i Donald Veizi në Budva Mal i Zi ishte 2 (dy) ditor (jo për arsye pune), organizuar me kolegët e punës, por qëndrimi në hotel ishte vetëm një natë. Për këtë udhëtim kompania Lufthansa, ku djali Donald Veizi është i punësuar, ka ofruar për çdo punonjës shumën 50 euro për mbulim të udhëtimit dhe hotelit. Shpenzimet nga ana e djalit ishin 5 euro për mbulimin e pjesës së mbetur së kostos së hotelit dhe transportit, si dhe rreth 15 euro për shpenzime të tjera për ushqim. Pra, në total për udhëtimin në Budva Mal i Zi, djali ka shpenzuar personalisht 20 euro.

Udhëtimi në Frankfurt Gjermani i Donald Veizi, nga data 27.06.2022 deri në 30.06.2022, ishte për arsye pune dhe është i përvitshëm me qëllim planifikimin e punës për muajt në vijim, mes kolegëve Shqiptarë dhe Gjerman. Fluturimi është blerë nga departamenti i Financës së kompanisë ku punon Donald Veizi. Gjithashtu shpenzimet e hotelit, transporti dhe ushqimi, i janë mundësuar nga kompania.

Paraqiti:

- Dokument nga sistemi TIMS, datë 15.12.2023, që vërteton se Petrit Veizi në periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, nuk ka dalë asnjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- Dokument nga sistemi TIMS, datë 15.12.2023, që konfirmon se Altina Veizi ka vetëm 1 (një) dalje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në datë 06.12.2021;
- Dokumentin nga sistemi TIMS, datë 15.12.2023, që konfirmon se Armand Veizi ka 1 (një) dalje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me datë dalje 28.02.2021 dhe datë hyrje 18.04.2021;
- Dokument Hospitali, datë 15.02.2021, lidhur ndërmjet Heinrich-Braun-Klinikum dhe Armand Veizi;
- Dokument i përkthyer nga Armand Veizi, që konfirmon se vajtja e tij në Gjermani ishte pasi ishte pranuar si hospitant në Departamentin e Neurologjisë në Heinrich-Braun Klinikum, për periudhën 01.03.2021 - 30.04.2021. Bashkëlidhur komunikimet me e-mail mes Armand Veizi me shefin e klinikës Dr. Merkelbach, të përkthyer edhe në gjuhën shqipe;
- Dokument nga sistemi TIMS, datë 15.12.2023, që konfirmon se Donald Veizi, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, ka 2 (dy) dalje jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht në datë 09.04.2022, nga Pika Kufitare Murriqan me autobus, si dhe në datë dalje 27.06.2022 dhe datë kthimi në 30.06.2022, nga Aeroporti i Rinasit për në Frankfurt Gjermani, nëpërmjet Kompanisë Lufthansa;
- Njoftim me e-mail për shpenzimet e udhëtimit dhe hotelit të ofruara nga kompania, si vijon: Hoteli kushton 55 euro nga të cilat 50 euro i ofron kompania dhe 5 euro duhet ti mbulojë personi;
- Deklaratë dore datë 14.12.2023, e Donald Veizi, për udhëtimin në Frankfurt Gjermani nga data 27.06.2022 deri në 30.06.2022, ku deklaron se: “Ky udhëtim ishte për arsye pune (i përvitshëm) me qëllim planifikimin e punës për muajt në vijim mes kolegëve Shqiptarë dhe Gjerman. Fluturimi është blerë nga departamenti financës së kompanisë, si bileta grupi. Gjithashtu shpenzimet e hotelit, transporti dhe ushqimi janë mundësuar nga kompania. Bashkëlidhur; e-mailet dhe bileta e udhëtimit në grup.

❖ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje-daljeve nga RSH, gjatë periudhës 2020 - 2022, të subjektit dhe personave të lidhur me të.**

❖ **Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës së sipërcituar rezultojnë në total rreth 20 euro e konvertuar në shumën rreth 2.300 lekë.**

69. **Për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar (fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të vlerësimit. Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së**

Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklaratimit të pasurisë.

- Shpenzime për arsimimin e djalit Armand Veizi në Fakultetin e Mjekësisë (publik) Tiranë, sipas vërtetimit të këtij institucioni (mandat arkëtimi Credins Bank). Shuma 179.328 lekë.
- Shpenzime për arsimimin e djalit Donald Veizi në Universitetin e Tiranë, Fakulteti Informatikës (publik) Tiranë. Shuma 89.664 lekë.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës.**

- Mandat arkëtimi datë 20.01.2016, nga Credins Bank, që konfirmon pagesën e shumës 29.888 lekë nga Armand Veizi, për vitin e III në Fakultetin e Mjekësisë. Mandat arkëtimi datë 09.02.2017, nga Credins Bank, që konfirmon pagesën e shumës 29.888 lekë nga Armand Veizi, për vitin e IV në Fakultetin e Mjekësisë.
- Mandat arkëtimi datë 29.01.2018, nga Credins Bank, që konfirmon pagesën e shumës 29.888 lekë nga Armand Veizi, për vitin e V në Fakultetin e Mjekësisë.

70. Në proces - verbalin e datës 22.12.2023 subjekti sqaroi se për djalin Armand Veizi, tarifa e vitit të gjashtë të studimeve në Fakultetin e Mjekësisë ishte gjysma e vlerës së tarifave të pesë viteve të mëparshme të shkollimit. Në total shpenzimet e studimeve për djalin Armand Veizi për 6 (gjashtë) vite në Fakultetin e Mjekësisë ishte rreth 164.384 lekë.

- Djali Donald Veizi ka ndjekur studimet në ciklin e parë Bachelor në Inxhinierinë Informatike pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe për vitin e I (parë) të studimeve nuk ka paguar tarifë studimi, pasi ka përfutuar bursë si student ekselent, ndërsa për vitin e II (dytë) dhe të III (tretë), ka paguar gjysmat e tarifave të studimeve në shumën totale 30.000 lekë. Deklarimi i shpenzimeve për djalin Donald Veizi, për periudhën e studimeve në vitet 2018 - 2021, në shumën 89.664 lekë është lapsus, pasi këto shpenzime janë përlogaritur gabim.

Paraqiti:

- Mandat Pageze nga Credins Bank, datë 12.12.2023, që konfirmon pagesën e tarifës së shkollimit për vitin e I (parë) në Fakultetin e Mjekësisë, datë 06.05.2014, në shumën 29.888 lekë;
- Mandat Pageze nga Credins Bank, datë 12.12.2023, që konfirmon pagesën e tarifës së shkollimit për vitin e II (dytë) në Fakultetin e Mjekësisë, datë 24.11.2014, në shumën 29.888 lekë;
- Mandat Pageze nga Credins Bank, datë 12.12.2023, që konfirmon pagesën e tarifës së shkollimit për vitin e III (tretë) në Fakultetin e Mjekësisë, datë 20.01.2016, në shumën 29.888 lekë;
- Mandat Pageze nga Credins Bank, datë 12.12.2023, që konfirmon pagesën e tarifës së shkollimit për vitin e IV (katër) në Fakultetin e Mjekësisë, datë 09.02.2017, në shumën 29.888 lekë;
- Mandat Pageze nga Credins Bank, datë 12.12.2023, që konfirmon pagesën e tarifës së shkollimit për vitin e V (pestë) në Fakultetin e Mjekësisë, datë 29.01.2018, në shumën 29.888 lekë;
- Mandat Pageze nga Credins Bank, datë 12.12.2023, që konfirmon pagesën e tarifës së shkollimit për vitin e VI (gjashtë) në Fakultetin e Mjekësisë, datë 07.03.2019, në shumën 14.944 lekë;
- Vërtetim me nr. **** prot., datë 15.12.2023 që vërteton se Armand Petrit Veizi ka filluar studimet pranë Fakultetit të Mjekësisë, Dega Mjekësi e Përgjithshme, në muajin tetor 2013, ka kryer

studimet 6-vjeçare me kohë të plotë dhe me vendim të komisionit Shtetëror të datës 30.07.2019, ka mbrojtur diplomën: Master i Shkencave në Mjekësi e Përgjithshme;

- Diplomë Master i Shkencave në Mjekësi e Përgjithshme për Armand Petrit Veizi, datë 25.09.2019;
 - Vërtetim nr. *** prot., datë 13.12.2023, nga Universiteti Politeknik, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, që vërteton se z. Donald Petrit Veizi ka ndjekur studimet në Ciklin e Parë Bachelor në Inxhinierinë Informatike pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe për vitin e I (parë) të studimeve (2018 - 2019) nuk ka paguar tarifë studimi, pasi ka përfitura bursë si student ekselent, ndërsa për vitin e II (dytë) të studimeve (2019 - 2020) dhe vitin e III (tretë) të studimeve (2020 - 2021), ka paguar gjysmat e tarifave të studimeve në shumën totale 30.000 lekë;
 - Diplomë Bachelor në Inxhinierinë Informatike, datë 06.04.2022, nga Universiteti Politeknik, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit për studentin Donald Petrit Veizi;
 - Certifikatë e Maturës Shtetërore datë 06.07.2018, nga Shkolla e Mesme e Përgjithshme “Sami Frashëri” për nxënësin Donald Petrit Veizi;
 - Diplomë e Maturës Shtetërore datë 06.07.2018, nga Shkolla e Mesme e Përgjithshme “Sami Frashëri” për nxënësin Donald Petrit Veizi.
- ❖ **Shpenzimet e deklaruara për arsimin e fëmijëve, në arsimin publik, gjatë periudhës deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, rezultojnë në total rreth 194.000 lekë.**
- ❖ **Subjekti ka pasur mundësi financiare për mbulimin e shpenzimeve për arsimimin e fëmijëve.**

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES – ALTINA VEIZI

DEKLARIMI PASURIVE

- ❖ **Nuk kam pasuri.**

71. Konfirmohet deklarimi i bashkëshortes së subjektit me dokumentacionin e administruar nga ASHK.

DEKLARIMI TË ARDHURAVE

- Të ardhura nga puna si llogaritëse në Ndërmarrjen “Broja” - Peshkopi, për periudhën 05.10.1993 deri në 27.09.1994, sipas Vërtetimit me nr. ***, datë 25.04.2018, të ISSH — Peshkopi (Nuk disponohet dokumentacion nga ngjarjet e vitit 1997). Shuma 24.450 lekë.
- Të ardhura nga “Pagesë Raport – Lindje” nga ISSH- Peshkopi, për periudhën 26.04.1995 deri në 25.04.1996, sipas Vërtetimit nr.***, datëlindjes 25.04.2018 të ISSH - Peshkopi. Shuma 35.416 lekë.
- Të ardhura nga “Pagesë Papunësie” nga ISSH- Peshkopi, për periudhën 26.04.1996 deri në 26.04.1997, sipas Vërtetimit, datëlindje 25.04.2018, të Drejtorisë Rajonale të Punësimit - Peshkopi. Shuma 34.259 lekë.
- Të ardhura nga “Pagesë Raport – Lindje” nga ISSH- Peshkopi, për periudhën 04.12.1999 deri në 04.12.2000, sipas Vërtetimit nr. 331, datëlindje 25.04.2018 të ISSH - Peshkopi. Shuma 54.235 lekë.

- Të ardhura nga “Pagesë Papunësie” nga ISSH- Peshkopi për periudhën 04.12.2000 deri në 04.12.2001, sipas Vërtetimit dt. 25.04.2018, të Drejtorisë Rajonale të Punësimit - Peshkopi. Shuma 64.223 lekë.
- Të ardhura neto nga puna si llogaritë në “EKB - Enti Kombëtar i Banesave”- Peshkopi për periudhën 05.12.2001 deri në 31.03.2002, sipas Vërtetimit nr. ***, dt. 25.4.2018 të ISSH - Peshkopi (Nuk disponohet dokumentacioni nga ngjarjet e vitit 1997). Shuma 168.000 lekë.
- Të ardhura nga “Pagesë papunësie për transferim” nga Ministria e Brendshme për periudhën 16.10.2003 deri në 16.03.2004, sipas Vërtetimit nr. ***, dt. 24.04.2018, të Drejtorisë së Financës së MB. Shuma 58.634 lekë.
- Të ardhura nga “Asistenca” nga Akademia e Policisë për periudhën 01.05.2004 deri në 26.12.2006, sipas Vërtetimit nr. **, dt. 20.04.2018, të “Akademisë së Sigurisë” Tiranë. Shuma 320.373 lekë.
- Të ardhura nga puna si financiere në aktivitetin privat (lokal) për periudhën 01.07.2009 deri në 01.04.2014. Nuk disponoj kontratë pune, pasi nuk kam qenë e siguruar. Shuma 175.000 lekë.
- Të ardhura nga puna sezonale (jo sistematike), si financiere në aktivitet të ndryshme private (biznese) për periudhën 01.04.2014 deri në 05.01.2015. Nuk disponoj kontratë pune, pasi nuk kam qenë e siguruar. Vlera 115.000 lekë.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga ISSH, që konfirmon se Altina Veizi, për periudhën janar 1994 - dhjetor 1994, ka realizuar të ardhura me punëdhënësin Ndërmarrja “Broja”, për të cilat është derdhur kontributi, por nuk ka emër.
 - Vërtetim për bazën e vlerësueshme me nr. *** prot., datë 25.04.2018, nga ISSH, që konfirmin se Altina Veizi për periudhën janar 2001 - dhjetor 2001, ka realizuar të ardhura me punëdhënësin EKB, për të cilat nuk ka lista.
 - Vërtetim nr. *** prot., datë 25.04.2018, nga ISSH, Drejtoria Rajonale Dibër, që konfirmon se Altina Veizi ka qenë e siguruar me Raport Lindje, për periudhën 26.04.1995 - 25.04.1996 dhe ka përfituar të ardhura në shumën 35.416 lekë dhe për periudhën 04.12.1999 - 03.12.2000 ka përfituar të ardhura në shumën 54.235 lekë.
 - Vërtetim nr. *** prot., datë 20.04.2018, nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë, që konfirmon se znj. Altina Veizi, bashkëshortja e Petrit Veizi, për periudhën 01.05.2004 — 31.12.2006, ka përfituar të ardhura neto nga asistenca bashkëshortore, në shumën 320.737 lekë.
 - Vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. **** prot., datë 24.04.2018, nga ISSH, që konfirmin se Altina Veizi për periudhën 01.09.2003 — 16.03.2004 ka realizuar të ardhura neto nga Ministria e Brendshme, në shumën 58.634 lekë.
 - Vërtetim për pagën neto mesatare, nga Drejtoria Rajonale e Punësimit Dibër, që konfirmon se Altina Veizi, për periudhën 26.04.1996 - 26.04.1997 dhe 04.12.2000 - 04.12.2001, ka realizuar të ardhura neto nga pagesa e papunësisë në shumën 98.482 lekë.
- 71. Raiffeisen Bank**, me shkresë me nr. *** prot., datë 07.08.2023, përcjell CD që konfirmon se Altina Veizi ka pasur llogari rrjedhëse në lekë dhe për periudhën 03.05.2005 - 10.01.2007, i janë kredituar në llogari të ardhura nga pagat, në shumën rreth 223.188 lekë.
- 72. ISSH**, me shkresë me nr. *** prot., datë 11.08.2023, nuk konfirmon të ardhura bruto/ neto për Altina Veizi deri në datë 09.03.2023.

73. Në proces verbalin e datës 22.12.2023, subjekti sqaroi se vlera e të ardhurave nga punësimi i bashkëshortes në Ndërmarrjen Broja - Peshkopi, për periudhën 05.10.1993 - 27.09.1994, në shumën 24.450 lekë, është vlera e pagesave me bordero për këtë periudhë kohore, por nuk disponon dokumentat e borderove. Kjo vlerë është deklaruar nga bashkëshortja me përafërsi, për sa i kujtohej për atë periudhë. Në deklaratën për vlerësimin kalimtar ka bashkëlidhur:

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga ISSH, që konfirmon se Altina Veizi, për periudhën janar 1994 - dhjetor 1994, ka realizuar të ardhura me punëdhënës Ndërmarrja Broja, për të cilat është derdhur kontributi, por nuk pasqyrohet vlera e të ardhurave. Nuk është munduar që të administronte dokumenta justifikues shtesë për të konfirmuar vlerën e të ardhurave të bashkëshortes për atë periudhë, pasi kjo ndërmarrje nuk është funksionale, që prej asaj periudhe.

Bashkëshortja Altina Veizi, për periudhën 01.05.2004 - 31.12.2006, ka përfituar të ardhura neto nga asistenca, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë në shumën 320.737 lekë. Për këto të ardhura subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar;

Vërtetimin datë 20.04.2018 nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë, që konfirmon të ardhurat e bashkëshortes Altina Veizi, nga asistenca, për periudhën 01.05.2004 - 31.12.2006, në shumën 320.737 lekë. Këto të ardhura, deri në muajin prill 2005, i ka marrë me bordero dhe nga muaji maj 2005 deri në janar 2007 i kanë kaluar në sistem bankar, konkretisht në Raiffeisen Bank. Të ardhurat nga pagat e bashkëshortes Altina Veizi që konfirmohen në Raiffeisen Bank, për periudhën 03.05.2005 - 10.01.2007, në shumën 223.188 lekë, janë të ardhurat e asistencës nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Akademia e Sigurisë, kur pagesat filluan të bëheshin nëpërmjet sistemit bankar.

Bashkëshortja ka punuar në biznese të ndryshme private si llogaritare, për periudhën korrik 2009 - dhjetor 2016, por nuk ishte e siguruar nga punëdhënësit. Pagesat vjetore ishin rreth 360.000 lekë (30.000 lekë në muaj). Sqaroi se këto paga, bashkëshortja i ka marrë cash jashtë sistemit bankar nga punëdhënësit, e pa siguruar në ISSH, pasi punëdhënësi nuk i bënte lidhjen e një kontrate pune. Për aktivitetet private ku bashkëshortja e subjektit ka punuar si llogaritare, nuk mund të siguronte dokumenta justifikues. Gjatë kësaj periudhe nuk kanë krijuar asetë dhe të ardhurat nga pagat e bashkëshortes dhe pagat e subjektit kanë shërbyer vetëm për të mbuluar shpenzimet bazë jetike.

- ❖ Të ardhurat neto të bashkëshortes së subjektit, për periudhën prill 1995 - dhjetor 2006, nga lejet e lindjes, pagesa e papunësisë dhe asistenca bashkëshortore nga Akademia e Sigurisë DPPSH, të dokumentuara, janë rreth 568.000 lekë. Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja gjatë vitit 1994 dhe 2001, në shumën totale rreth 192.000 lekë, pranë Ndërmarrjes “Broja” Peshkopi dhe Entit Kombëtar të Banesave, Peshkopi, për të cilat nuk disponon dokumentacion justifikues financiar.
- ❖ Për periudhën korrik 2009 - dhjetor 2016, bashkëshortja ka deklaruar të ardhura në shumën rreth 2.700.000 lekë (30.000 lekë/muaj) nga puna si llogaritare në biznese bar-kafe, e pasiguar, për të cilat nuk disponon dokumentacion iustificues, të ardhura të cilat nuk kanë shërbyer për krijim asetesh, por vetëm për të mbuluar shpenzimet bazë jetike.

DEKLARIMI I DJALIT - ARMAND VEIZI

DEKLARIMI I PASURIVE

74. Llogari në bankën Credins me nr. *****. Burimi: Të ardhurat nga paga si Mjek. Vlera 933.273,96 lekë. Zotëron 100%.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, datë 09.03.2023, që konfirmon se Armand Veizi ka llogari page me gjendje në datë 09.03.2023, në shumën 933.273 lekë.

75. **Credins Bank** me shkresë me nr. **** prot., datë 27.09.2023, konfirmon se Armand Veizi ka llogari page, me gjendje në datë 09.03.2023, në shumën 932.773 lekë.

→Konstatohet: Llogaria e Armand Veizi, në Credins Bank, është krijuar gjatë periudhës 2021 - 2022 me burim të ardhurat nga pagat si mjek.

- ❖ **Konfirmohet deklarimi i djalit të subjektit me dokumentacionin e dorëzuar. Credins Bank konfirmon gjendje llogari në datë 09.03.2023 në shumën 932.773 lekë.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

76. Llogari në bankën Credins me nr. *****. Burimi: Të ardhurat nga paga si Mjek. Shuma 933.273,96 lekë. Zotëron 100%.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Nxjerrje llogarie me nr. *****, nga Credins Bank, datë 09.03.2023, që konfirmon se Armand Veizi ka llogari rrjedhëse dhe për periudhën 24.09.2014 - 29.05.2015 i janë kredituar në llogari “dhënie stimuli si nxënës me nota 10-ta”, nga Shkolla “Sami Frashëri”, në shumën rreth 25.000 lekë.
- Nxjerrje llogarie me nr. *****, nga Credins Bank, datë 09.03.2023, që konfirmon se Armand Veizi ka llogari page dhe për periudhën 28.06.2019 - 03.11.2022, i janë kredituar në llogari të ardhura për dhënie stimuli nxënësit Armand Veizi dhe të ardhurat nga pagat neto nga Qendra Shëndetësore Sauk dhe QEZHEF, në shumën rreth 970.407 lekë. Në datat 14.01.2022 dhe 17.02.2022 në llogarinë e Armand Veizi, janë transferuar nga banka të tjera me përshkrimin “BILIM Ilac SAN VE TIC Speaker Fee”, shuma totale 24.700 lekë.

77. **Credins Bank** me shkresë me nr. **** prot., datë 27.09.2023, konfirmon se Armand Veizi, ka pasur llogari për fëmijë dhe për periudhën 27.04.2011 - 29.05.2015 dhe datë 28.06.2019, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga bursa nga Shkolla “Sami Frashëri” si nxënës me rezultate të larta dhe kreditime nga stimuli si nxënës me rezultate të larta, në shumën totale rreth 135.000 lekë.

78. **ISSH** me shkresë me nr. **** prot., datë 11.08.2023, konfirmon se Armand Veizi për periudhën korrik 2021 — tetor 2022 ka përfituar të ardhura neto nga pagat nga Qendra Shëndetësore Sauk.
79. **Në proces verbalin e datës 22.12.2023**, subjektit sqaroi se 2 (dy) transfertat në llogarinë e djalit Armand Veizi, në Credins Bank, në shumën totale 24.700 lekë, janë pagesa të kryera nga depo farmaceutike “BILIM Ilac SAN VE TIC Speaker Fee”, për arsye se djali Armand Veizi ishte i ftuar si folës në dy konferenca mjekësore të organizuara nga kjo përfaqësi në Shqipëri. Përfaqësuesja mjekësore e kësaj depo e asaj kohë, nuk është më pjesë e kësaj përfaqësie dhe përfaqësia e ka selinë në Turqi, me të cilën Armand Veizi, nuk ka kontakte për të siguruar vërtetimet që konfirmojnë pjesëmarrjen e tij në këto konferenca. Shuma totale prej 24.700 lekë, e transferuar në llogarinë e djalit Armand Veizi, në datat 14.01.2022 dhe 17.02.2022 është e ardhur e tij.
- ❖ Të ardhurat neto të djalit të subjektit Armand Veizi, nga bursa. për periudhën prill 2011 - qershor 2019 dhe nga pagat neto dhe pjesëmarrja në konferenca mjekësore, për periudhën korrik 2021 - nëntor 2022, të konfirmuara nga institucionet bankare, janë në shumat rreth 1.111.000 lekë.

DEKLARIMI I DJALIT- DONALD VEIZI

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

80. Llogari në Raiffeisen Bank, me nr. *****. Burimi: Të ardhurat nga paga kompania ku është i punësuar “LUFTHANSA Frankfurt”. Shuma 1.167.390 lekë. Zotëron 100%.
- **Bashkëlidhur deklaratës:**
- Nxjerrje llogarie me nr. *****, nga Credins Bank, datë 09.03.2023, që konfirmon se Donald Veizi ka pasur llogari rrjedhëse dhe për periudhën 14.02.2019 - 31.07.2019, i janë kredituar në llogari të ardhura nga bursa nga Universiteti Politeknik, Fakulteti Teknologjisë Informatike, në shumën rreth 76.000 lekë.
 - Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 09.03.2023, që konfirmon se Donald Veizi ka llogari page dhe për periudhën 04.03.2022 - 02.02.2023, i janë kredituar në llogari të ardhura nga pagat, në shumën rreth 1.165.779 lekë. Gjithashtu, konfirmohet gjendje llogarie në datë 28.02.2023, në shumën 103.284 lekë.
81. **Raiffeisen Bank**, me shkresë me nr. **** prot., datë 07.08.2023, përcjell CD që konfirmon se Donald Veizi ka llogari page dhe për periudhën 04.03.2022 - 01.03.2023, i janë kredituar në llogari të ardhura neto nga pagat, në shumën rreth 1.273.963 lekë. Konfirmohet gjendje llogarie në datë 09.03.2023, në shumën 210.424 lekë.
82. **Credins Bank**, me shkresë me nr. **** prot., datë 27.09.2023, konfirmon se Donald Veizi, ka pasur llogari për fëmijë dhe për periudhën 21.10.2014 - 12.05.2015 i janë kredituar në llogari të ardhura për dhënie stimuli si nxënës me nota 10-ta nga shkolla 9-vjeçare “Servete Maçi” në shumën rreth 15.000 lekë ndërsa për periudhën 14.02.2019 - 31.07.2019, i janë kredituar në llogari të ardhura nga bursa e studimit nga Universiteti Politeknik, Fakulteti Teknologjisë Informatike, në shumën rreth 76.000 lekë.

83. **ISSH**, me shkresë me nr. **** prot., datë 11.08.2023, konfirmon se Donald Veizi për periudhën nëntor 2021 - mars 2023 ka përfituar të ardhura neto nga pagat nga Lufthansa Industry Solutions.
84. **Në proces verbalin e datës 22.12.2023**, subjektit sqaroi se: në llogarinë rrjedhëse të djalit Donald Veizi, pranë Raiffeisen Bank, i janë kredituar pagat e tij nga punëdhënësi, kompania Lufthansa Industry Solution Shpk. Meqënëse dokumenti nxjerrje llogarie, nga Raiffeisen Bank, që i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar, ishte për periudhën deri në muajin shkurt 2023, kreditimet e pagës dhe gjendja në llogari i përkasin kësaj periudhe dhe nuk përfshijnë pagën mujore të muajit mars 2023. Sqaroi se pavarësisht se në deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar, djali nuk ka deklaruar gjendjen e kësaj llogari në datë 09.03.2023, kësaj deklarate i ka bashkëlidhur dokumentin nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, që konfirmon gjendjen e kësaj llogarie në muajin shkurt 2023 dhe që është fakt që ky veprim, nuk ishte i qëllimshëm.
- ❖ **Të ardhurat neto të djalit të subjektit Donald Veizi nga bursa, për periudhën tetor 2014 - korrik 2019 dhe nga pagat neto për periudhën mars 2022 - mars 2023, të konfirmuara nga institucionet bankare, janë në shumën rreth 1.365.000 lekë.**
85. Në Deklaratën e Pasurisë për Vlerësimin Kalimtar, nga subjekti Petrit Veizi në rubrikën “Adresa e plotë ku jeni të regjistruar në gjendjen Civile” është deklaruar: Njësia Administrative nr. 9, 101, rruga e Barrikadave, pallati Nr. **, H. *, Ap. **, Bashkia Tiranë. Nuk disponon vendqëndrim tjetër.

Trajtuar më sipër.

86. Banka e Shqipërisë, Intesa Sanpaolo Bank, Tirana Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, ProCredit Bank, Banka e Parë e Investimeve, OTP Bank Raiffeisen Leasing, Porche Leasing, Albania Leasing, Landesleasing, Raiffeisen Invest, Credins Invest, Unioni Financiar i Tiranës, Easypay, Fondi Besa, Insitucioni Financiar NOA, Iute Credit Albania Kredo Financë, konfirmojnë se subjekti Petrit Veizi, dhe personat e lidhur **nuk janë klientë të tyre**, ç’ka konfirmohet me deklarinimin.
87. Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së, dhe konkretisht: Tirana Jug, Zonat e Stimuluara Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Librazhd Mallakastër, Fier, Gjirokastër, Devoll, Lushnje, Korçë, Berat, Pogradec, Kukës, Kavajë, Gramsh, Malësi e Madhe, Kuçovë, Kamëz Vorë, Pukë, Peqin, Skrapar, Bulqizë, Has, Kolonjë, Elbasan, Mirditë, Tropojë, Tepelenë, Përmet, Mat, Shkodër, Sarandë, Krujë, Kurbin, Lezhë **nuk konfirmojnë** pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.
88. **BKT**, me shkresë me nr. **** prot., datë 14.08.2023, konfirmon se Donald Veizi ka llogari rrjedhëse në euro, në të cilën nuk rezultojnë kreditime. Gjendja në llogari në datë 09.03.2023 është në shumën 0 euro.
89. **ABI Bank**, me shkresë me nr. *** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se Petrit Veizi, mban llogari në euro me numër *****, hapur në datë 01.12.2010 në shumën 0.66 euro. Në llogari nuk rezultojnë kreditime. Gjendja në llogari në datë 09.03.2023 është 0.66 euro.

Petrit Veizi, ka llogari Visa Prepaid General në lekë, me gjendje në datë 09.03.2023, në shumën 151 lekë. Për periudhën 30.10.2012 - 24.01.2013 ka kredituar në llogari rreth 30.700 lekë dhe ka kryer blerje on-line me jashtë, në shumën rreth 28.339 lekë.

Armand Veizi, ka llogari Visa Prepaid General në lekë, me gjendje në datë 09.03.2023 në shumën 181 lekë. Për periudhën 27.10.2021 - 02.3.2023 ka transferuar në llogari me internet banking rreth 41.192 lekë dhe ka kryer blerje on-line me jashtë në shumën rreth 36.538 lekë.

Armand Veizi, ka llogari Visa Prepaid General në lekë, me gjendje në datë 09.03.2023 në shumën 339 lekë. Për periudhën 29.12.2014 - 13.6.2019 ka kredituar në llogari rreth 27.600 lekë dhe ka kryer blerje on-line me jashtë në shumën rreth 25.501 lekë.

Donald Veizi, ka llogari Visa Prepaid Studenti në lekë, me gjendje në datë 10.3.2023, në shumën 79 lekë. Për periudhën 09.02.2018 - 08.08.2022, ka kredituar në llogari, ka transferuar me internet banking dhe i janë kredituar nga rimbursimet rreth 126.151 lekë dhe ka kryer blerje on-line me jashtë, në shumën rreth 123.200 lekë.

90. **AK Invest**, me shkresë me nr. ***** prot., datë 10.08.2023, konfirmon se shtetasit: Petrit Veizi, Armand Veizi dhe Donald Veizi, nuk kanë kryer transfertat monetare nëpërmjet rrjetit të AkInvest Sha.

91. **OKB**, me shkresë nr. ***** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se për periudhën deri më 09.03.2023, shtetasi Petrit Veizi dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë të jenë pajisur me NUIS (NIPT), si persona fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruar pranë regjistrimit tregtar.

92. **DPT**, me shkresën nr. ***** prot., datë 07.08.2023, konfirmon se shtetasi Petrit Veizi dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.

93. **Drejtoria e Përgjithshme Detare**, me shkresën nr. *****, datë 11.08.2023, nuk konfirmon mjete lundruese në pronësi të shtetasit Petrit Veizi dhe familjarëve të tij.

✚ **Në përfundim të hetimit të kryer:** Trupa e Vlerësimit, në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme 33 dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me Ligjin nr.12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktoritetit u mbështetet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi:

- Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- Nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- Nuk është kryer deklarim i remë;
- Nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë:

- (i) *Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;*
- (ii) *Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;*
- (iii) *Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërmra (ë), e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*

Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit z. Petrit Veizi, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë së deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.

Për kontrollin e figurës Trupa e Vlerësimit administroi:

- ✓ Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”;
- ✓ Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

94. Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, është struktura përgjegjëse për kontrollin e figurës së subjektit të vlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 42 pika 1, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit, raporti për subjektin e vlerësimit, me nr. *** Prot, datë 05.02.2024, i përpiluar me përgjigjet e organeve ligjzbatuese dhe institucioneve shtetërore, në të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të vlerësimit z. Petrit Veizi.

95. Në deklaratën “Kontrolli i Figurës”, subjekti i vlerësimit ka deklaruar si vijon:

- Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qenë asnjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.

- Nuk është caktuar ndonjëherë ndaj tij masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- Ndaj tij nuk është lëshuar asnjëherë një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Ndaj tij nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së Subjektit.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish – shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit.

Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, janë kryer veprimet duke kërkuar të dhëna nga institucionet të shprehura në këtë ligj si më poshtë:

96. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën e “I Kufizuar”, Nr.*** Prot, datë 15.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi, bën me dije se:

- Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi.

97. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën “I Kufizuar”, Nr.*** Prot, datë 09.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi, si dhe personat e lidhur me të, bën me dije se:

- Nuk rezultojnë të dënuar.

98. Institucion ligjbatues, me shkresën “Sekret”, Nr. *** Prot, datë 09.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi, si dhe personat e lidhur me të, bën me dije se:

- Nuk kanë të dhëna në lidhje me cënimin e sigurisë kombëtare, apo aktivitet të kundërligjshëm.

99. Institucion ligjbatues, me shkresën “I kufizuar” Nr.*** Prot, datë 18.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi, si dhe personat e lidhur me të:

- **Nuk kanë** të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
- **Nuk kanë** të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në *krimin e organizuar*, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”) ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;
- **Nuk kanë** të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (*persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar*);
- **Nuk kanë** të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;
- **Nuk kanë** të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;
- **Nuk kanë** të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
- **Nuk kanë** të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
- **Nuk kanë** të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-s;

- **Nuk kanë** të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.

100. Institucion ligjbatues, me shkresën “Konfidencial”, Nr. *** Prot, datë 11.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi, bën me dije se:

- Nuk disponon të dhëna.

101. Institucion ligjbatues, me shkresën “Sekret” e datës 03.08.2023 dhe shkresën “Sekret” Nr. ***.Prot, të datës 03.10.2023, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 16.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi, dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- **Nuk kanë** të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm;
- **Nuk ka** procedime penale të referuara;
- Për subjektin e vlerësimit, **nuk** administrohen ankesa, të dhëna ose informacione që lidhjen me objektin e kërkesës.

102. Institucion ligjbatues, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 31.10.2023, dhe me shkresën “I Kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 07.05.2024, për subjektin e vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi, bën me dije se:

- **Nuk** është nxjerrë urdhër ndalimi;
- **Nuk** është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
- **Nuk** është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
- **Nuk ka pasur** regjistrim të njoftimit të veprave penale;
- **Nuk ka pasur** raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.

103. Institucion ligjbatues, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot (R.M), datë 02.08.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi:

- **Nuk** rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

104. Institucion ligjbatues, me shkresën “Sekret”, Nr. ***.Prot, datë 16.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi, dhe personat e lidhur me të sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- **Nuk rezultuan** raportime për subjektin e vlerësimit Petrit Veizi dhe për personat e lidhur Altina Veizi, Armand Veizi, Donald Veizi.

105. Institucion ligjzbatues, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 15.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi, bën me dije se:

Z. Petrit Mustafa Veizi është i pajisur me Certifikatë Sigurie personeli (CSP), nr. **** në nivelin “Tepër Sekret”, lëshuar më datë 27.05.2021, e vlefshme deri më datë 26.05.2026.

Nga AKSIK nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP.

AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

106. Avokati i Popullit, me shkresën “E Paklasifikuar”, Nr. **** Prot, datë 14.08.2023, për subjektin e vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi, bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

107. Institucion ligjzbatues, me shkresën “I kufizuar”, Nr. *** Prot, datë 24.11.2023, për subjektin e vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi, bën me dije se:

- Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri 2 Korrik 1991.

Denoncime nga publiku

108. Për subjektin e vlerësimit z. Petrit Mustafa Veizi, **nuk është disponuar asnjë ankese** nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

Testi për përdorim lëndësh narkotike:

109. Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore, “Për kryerjen e ekspertimeve toksikologjike”, ka kryer ekspertimin toksikologjik të një mostre urine, mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike.

Në bazë të rezultateve të përfituara nga ekspertiza toksikologjike për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se:

Subjekti vlerësimit z. Petrit Veizi, aktualisht nuk rezulton përdorues i lëndëve narkotike.

✚ **Në përfundim të hetimit të kryer për kontrollin e figurës:** Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Petrit Veizi, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figures, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjensitë ligjzbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me Ligjin Nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se: subjekti i vlerësimit Petrit Mustafa Veizi:

- Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;
- Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45 dhe 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit.

Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- a. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- b. Raportin e përgatitur nga Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

111. Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me nenin 46 pika 2, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit, për subjektin e vlerësimit z. Petrit Veizi, raportin e vlerësimit të aftësive profesionale me Nr. *** Prot., datë 13.09.2023, të përpiluar në mënyrë të hollësishme dhe të arsyetuar, në të cilin është konstatuar se:

Punonjësi i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, Petrit Veizi, është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme, duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban.

HETIMI ADMINISTRATIV

112. Subjekti i vlerësimit, Petrit Veizi, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Drejtorit, në Drejtorinë Rajonale Durrës - Kavajë, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe me Urdhër Nr.***, datë aktualisht në funksionin e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Fier – Berat.

113. Në zbatim të pikës 2 dhe 3 të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, ku përcaktohet se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij Ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën/pozicionin që mban, jo më shumë se 5 (pesë) vjet.

114. Vlerësimi i aftësive profesionale mbështetet në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit me nr. ***.
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, të mbështetura në dokumentacionin shoqërues të dorëzuara nga vetë subjekti.
- Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Financës dhe e Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore mbi performancën e subjektit.

Në Formularin e Aftësive Profesionale subjekti deklaron:

❖ **Të dhëna për Arsimimin:**

- Arsim i Lartë – Shkollën e Lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
- Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja – Dëshmi – gjuha Serbo – Kroate.

115. Sipas të dhënave të administruara në Dosjen Personale të subjektit, rezulton së subjekti ka përfunduar arsimin e lartë. Në kuptim të Ligjit nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar, rezulton se:

- ✓ **Subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që ushtron pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.**

116. Masat Disiplinore:

Referuar raportit të dërguar nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ku konfirmon se ka verifikuar dokumentacionin në dosjen personale të subjektit, rezulton së gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018- mars 2023) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

- ✓ *Nuk është ndëshkuar me masë disiplinore.*
- ✓ *Deklarimi i subjekti është i saktë.*

117. Vlerësimet e punës:

Neni 45, pika 2, shkronja (ç), e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë dhe vlerësimet e punës.

Në dosjen e personelit të subjektit gjenden vlerësimet e performancës për vitet 2019 - 2021. Për periudhën 2018 dhe 2022, në dosjen personale të subjektit të vlerësimit nuk administrohen vlerësimet e rezultateve individuale të punës. Bazuar në sistemin e vlerësimit dhe pikëzimit të rezultateve të punës për performancën vjetore, rezulton se subjekti është vlerësuar përgjithësisht në të dyja vitet me thuajse pikët maksimale për punën e kryer si më poshtë:

- Vlerësimi i rezultateve individuale të punës, periudha 01/01/2019 - 31/12/2019, vlerësimi i përgjithshëm është “shumë mirë”.
- Vlerësimi i rezultateve individuale të punës, periudha 01/01/2020 - 31/12/2020, vlerësimi i përgjithshëm është “shumë mirë”.
- Vlerësimi i rezultateve individuale të punës, periudha 01/01/2021 - 31/12/2021, vlerësimi i përgjithshëm është “shumë mirë”.

Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e inregritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.

118. Pranë AMP-së, **nuk** kanë ardhur denoncime/ankesa nga publiku për subjektin për sjellje joprofesionale dhe jo-etike, gjatë ushtrimit të detyrës.

- ❖ Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara nga trupa e vlerësimit, konkludohet:
- ✓ *Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.*
- ✓ *Subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, ka respektuar rregullat e etikës, si edhe ka shfaqur performancë të lartë funksionale.*

Të dhëna për Kualifikimet Profesionale, Trajnime, Konferencat Shkencore.

Në pikën 3, të formularit të aftësive profesionale, subjekti përgjatë viteve deklaron pjesëmarrjen në konferenca brenda dhe jashtë vendit, kurse trajnimi brenda dhe jashtë vendit duke cituar edhe çertifikatat përkatëse të marra lidhur me këto veprimtari.

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit.

Trupa e vlerësimit vë në dukje faktin se, dokumentacioni bashkëlidhur raportit të vlerësimit, përmban certifikata trajnimesh për subjektin e vlerësimit të një periudhë relativisht të hershme, për harkun kohor të sipër cituar mësipër. Në përputhje me dispozitat e ligjit të vlerësimit, kjo periudhë nuk është objekt

vlerësimi dhe për këtë arsye këto kualifikime nuk do të trajtohen në kuadrin e kualifikimeve të përfituara nga subjekti i vlerësimit për periudhën (2018 – mars 2023)

Gjithashtu, gjatë karrierës rezulton se subjekti nuk ka marrë certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave konkrete.

Trupa e Vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë AMP-së, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstatoj se gjatë periudhës 2018 – mars 2023, të vlerësimit në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

1. Nuk ka realizuar asnjë trajnim;
2. Nuk ka asnjë kualifikim;
3. Nuk ka marrë asnjë certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave.

Trupa e vlerësimit konstaton se gjatë periudhës së vlerësimit subjekti **nuk gëzon asnjë kualifikim/trajnim/medalje.**

ECURIA NË KARRIERË.

119. Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit.

Nga verifikimi në dosje personale rezulton se gjatë periudhës 2018 – mars 2023, objekt deklarimi, subjekti ka ecuri në karrierë si vijon:

1. Aktualisht, Drejtor, i Drejtorisë Rajonale Fier - Berat, në Drejtorinë e Përgjithshme të AMP-së, emëruar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, nr. ** datë 25.01.2024 “Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi te AMP-së”.
2. Drejtor, i Drejtorisë Rajonale Durrës-Kavajë, në Drejtorinë e Përgjithshme të AMP-së, emëruar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, nr. ** datë 31.01.2023 “Për transferimin dhe emërimin në detyrë të një punonjësi te AMP-së”.
3. Drejtor i Drejtorisë Rajonale Kukës-Dibër, në Drejtorinë e Përgjithshme të AMP-së, emëruar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, nr. *** datë 02.03.2020 “Për caktimin në detyrë dhe transferimin e një punonjësi të AMP-së”.
4. Specialist në Drejtorinë e Hetimit të AMP-së, për nevoja puna komandohet në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Elbasan – Korçë të AMP-së, me urdhër nr. ***, datë 01.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së.
5. Specialist, në Drejtorinë e Verifikimit të Pastertisë dhe Monitorimit të Brendshëm të AMP-së, emëruar me urdhër te Drejtorit të Përgjithshëm nr. ***, datë 02.12.2018.
6. Shef Sektori, në Sektorin e Drejtimit në Drejtorinë e Kërkimit dhe Hetimit, me gradën “Drejtues i Shërbimit”, për shkak të ndryshimeve strukturore caktohet në detyrë Specialist në Drejtorinë e

Hetimit te AMP-së, në Drejtorinë e Përgjithshme të AMP-së, sipas urdhërit nr.***, datë 27.11.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së.

- ❖ Në lidhje me përputhshmërinë e gradës me funksionin/pozicionin e punë, subjekti i vlerësimit ka përfituar gradën si me poshtë:
- Me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. ***, datë 21.10.2015 ka përfituar Gradën Drejtues i Shërbimit.

Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”, punonjësit e AMP-së nuk mbajnë më grada, duke filluar nga muaji Shkurt 2022, pra nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji.

- a. Në përfundim, në lidhje me ecurinë në karrierë të z. Petrit Veizi, bazuar në deklaratimet e bëra, verifikimet nga dokumentacioni i administruar, trupa e vlerësimit konkludon se:
 - ✓ ***Funksionet në të cilat është emëruar subjekti dhe gradat e përfituara gjatë karrierës, janë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.***

120. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshope, seminare botime brenda dhe jashtë vendit.

Subjekti i vlerësimit Petrit Veizi për periudhën 2018 - 2023, nuk ka marr pjesë në asnjë konferencë, workshop, seminar apo botim brenda dhe jashtë vendit.

NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER

121. Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se, subjekti i vlerësimit Petrit Mustafa Veizi:

- Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;
- Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;
- Ka vlerësime pozitive pune.

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e

subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 12.07.2024, ftoi subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 19.07.2024, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Petrit Mustafa Veizi, në përputhje me nenin 60 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;*
- *Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.*

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, **z. Petrit Mustafa Veizi**, me funksion Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Fier – Berat.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 19.07.2024.

TRUPA E VLERËSIMIT

Klevis DHIGOI
Kryesues

Erjana PJETRI
Relatore

Ersa KARAJ
Anëtare